

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
MAJ - NËNTOR 2023**

Nr. rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e Përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	30.05.2023	<p>Per qellime hetimi te procedimit penal nr. 460, viti 2023 kerkojme:</p> <p>1.Te na dergoni informacion nese shtetasi A.B apo ndonje shtetas tjeter kane paraqitur ankim per pushtim toke ne pasurine nr. 1337/J ZK 1465 apo per ndertim te paligjshem te nje muri rrethues nga shtetasi Q.S.C banues ne Kçar I Poshtem, Njesia Adm. Gruemire.</p>	22.06.2023	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me nr.4896/1 datë 29.05.2023 dhe protokolluar me tonën me Nr.1323 Prot. date 30.05.2023 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion ndertim pa leje (muri rrethues) nga ana e shtetasit Q.S.C banues në fshatin Kçar I Poshtem, njs Adm Gruemirë, Bashkia Malesi e Madhe:</p> <p>Në lidhje me shtetasin Q.S.C banues në fshatin Kçar I Poshtem, njs Adm Gruemirë, IVTM Malësi e Madhe ka hartuar proces verbalin për kundrvatjen nr.26 datë 05.06.2023 i cili ka konstatuar:</p> <p>Bazuar në Ligjin Nr. 408, datë 13.5.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT ky lloji ndetimi nuk është ndertim pa leje pasi muri ka qënë ekzistues dhe thjeshte është berë riparim i tji sipas Nenit 6.</p>	Përfunduar	Nuk ka

				<p>Bashkangjitur po ju dergojmë edhe Proces Verbalin e hartuar nga IVMT Malësi e Madhe.</p> <p>Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>		
2.	16.06.2023	<p>Kerkim informacioni mbi vendodhjen e vendit te quajtur Fshati Vukpalaj, me koordinata 42'19' 01.5" ; 19 26' 27.9" ne Njësinë Administrative Kastrat Bashkia Malesi e Madhe.</p>	11.09.2023	<p>Për sa kërkoni ne shkresën tuaj Nr. 5304 Prot. Date 07.06.2023 e administruar nga ana jone me shkresën Nr. 1443 Prot te dates 16.06. 2023 ju sqarojmë si me poshtë :</p> <p>Vendi i quajtur Fshati Vukpalaj, me koordinata 42'19' 01.5" ; 19 26' 27.9" ne Njësinë Administrative Kastrat Bashkia Malesi e Madhe ndodhet ne fond pyjor. Ngastra nr 88a Ekonomia Pyjore Bajze-Hot. Inspektori i pyjeve qe mbulon kete zone eshte Z. Gac Narkaj me nr. Kontakti xxxxxxxxxxxx</p> <p>Faleminderit per mirekuptimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka

3.	27.06.2023	Kerkim informacioni per vendin i quajtur Fshati Rrjoll, me koordinata 42' 12' 56'' ; 19 35' 34'' ne Njësinë Administrative Shkrel Bashkia Malesie Madhe.	13.09.2023	Për sa kërkoni ne shkresën tuaj Nr. 5851/1 Prot. Date 23.06.2023 e administruar nga ana jone me shkresën Nr. 1539 Prot te dates 27.06. 2023 ju sqarojmë si me poshtë : Vendi i quajtur Fshati Rrjoll, me koordinata 42' 12' 56'' ; 19 35' 34'' ne Njësinë Administrative Shkrel Bashkia Malesie Madhe ndodhet ne fond pyjor, Ngastra nr 62; Ekonomia Pyjore Rrjoll. Faleminderit per mirekuptimin!	Përfunduar	Nuk ka
4.	31.07.2023	Kerkim informacioni per vendin e quajtur Fshati Vukpalaj, me koordinata 42'19' 26.9'' ; 19 26' 27.8'' ne Njësinë Administrative Kastrat Bashkia Malesi e Madhe.	11.09.2023	Për sa kërkoni ne shkresën tuaj Nr.6792/1 Prot. Date 26.07.2023e administruar nga ana jone me shkresën Nr,1875 Prot te dates 31.7. 2023 ju sqarojmë si me poshtë Vendi i quajtur Fshati Vukpalaj, me koordinata 42'19' 26.9'' ; 19 26' 27.8'' ne Njësinë Administrative Kastrat Bashkia Malesie Madhe ndodhet ne fond pyjor, Ngastra nr 87a Ekonomia Pyjore Bajze-Hot. Inspektori i pyjeve qe mbulon kete zone eshte Z. Gac Narkaj me nr. Kontakti xxxxxxxxxxxx Faleminderit per mirekuptimin!	Përfunduar	Nuk ka

5.	23.08.2023	<p>Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr.278 vitit 2023, për veprat penale të parashikuar nga neni 284, 279/1 i Kodit Penal. Për nevoja të hetimit të mëtejshëm të çështjes, kërkohet nga ana juaj të na informoni si më poshtë vijon:</p> <p>1.A mund të na konfirmoni se cilës Njësi Administrative i përket adresa me këto të dhëna: Kordinatat 42.233251,19.423877 në vendin e quajtur Lashaj.</p> <p>2.Na vini në dispozicion të dhënat e tokave që përfshihen në fondin pyjor, që administrohen nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve Bashkia Malësi e Madhe.</p>	07.09.2023	<p>Në vijim të shkresës tuaj me nr prot 7249 me date 16.08.2023 protokolluar me tonen me nr prot. 2109 dt. 23.08.2023 ku ju kërkoni informacion për nevoja hetimore në lidhje me vepren penale nga neni “284“ i Kodit Penal me koordinata gjeografike : 42.233251,19.423877</p> <p>Ju sqarojmë që toka me të dhënat bashkelidhur shkreses i perket Njesisë Administrative Kastrat. Sipas VKM Nr. 433, datë 8.6.2016, i ndryshuar, janë miratuar listat e inventareve për transferimin e pyjeve dhe kullotave publike në pronësi të Bashkive, procedurë e cila nuk është përfunduar akoma dhe vazhdon të jetë në shqyrtim. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	------------	--------

6.	08.09.2023	<p>Për nevoja të hetimit të procedimit penal me nr.677/2023, I regjistruar për veprën penale të “Kultivimi I bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal. kërkohet informacion në lidhje me parcelat me këto koordinata gjeografike N 42 32 02 10 E 19 60 44 , te ndodhura në një zonë të pyllëzuar , ne 1 mini parcelë me sipërfaqe 25 m2, në fshatin Shkrel Malësi e Madhe. në të cilat janë konstatuar të mbjedha lënde te dyshuara si cannabis sativa.</p> <p>Kërkohet informacion nga ana e juaj nëse kjo sipërfaqe toke me këto koordinata është sipërfaqe në pronësinë e Drejtorisë së Pyjeve Malësi e Madhe.</p>	30.10.2023	<p>Për sa kërkoni ne shkresën tuaj Nr. 7367/2 Prot. Date 04.09.2023 e administruar nga ana jone me shkresën Nr. 2317/1 Prot te dates 08.9. 2023 ju sqarojmë si me poshtë Pas verifikimit te kordinatave me OPGJ prane Komisariatit te Malesise se Madhe per vendin e quajtur fshati Shkrel Nj.Adm. Shkrel rezulton se kjo siperfaqe eshte ne administrim te Drejtorise se Administrimit te pyjeve pasi ndollet ne fond pyjore, ne Ekonomine Pyjore Bzhete-Dedaj ngastra nr 100/a.</p>	Përfunduar	Nuk ka
7.	08.09.2023	<p>Kërkim informacion për pronësi në fshatin Vajush Njësia Administrative Gruemirë për rastin e preçedimit penal Nr 655</p>	10.10.2023	<p>Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në vijim të shkresës tuaj Nr. 7651 Prot., datë 12.09.2023, administruar me Nr. 2357 Prot., datë 08.09.2023 ku kërkoni informacion për pronësi në</p>	Përfunduar	Nuk ka

		me kordinata gjeografike: N 42°12'23'-E 19° 31' 34'		fshatin Vajush Njësia Administrative Gruemirë për rastin e precedimit penal Nr 655 me kordinata gjeografike: N 42°12'23'-E 19° 31' 34' Ju sqarojmë se sipas VKM-së, Nr. 433, datë 8.6.2016, i ndryshuar, janë miratuar listat e inventareve për transferimin e pyjeve dhe kullotave publike në pronësi të Bashkive, procedurë e cila nuk ka përfunduar akoma regjistrimi . Faleminderit për mirëkuptimin!		
8.	26.09.2023	Bazuar në ligjin nr. '07/2016. "Për Prefektin e Qarkut", Ligjin nr. 45/2019. "Për Mbrojtjen Civile", Ligjin. nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". VKM nr. 923. dt 25.12.2020 "Për funksionimin e organizimit të Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimit ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile. VKM.	29.09.2023	Bashkia Malësi e Madhe dhe strukturat e tjera të vartësisë, gjatë vitit 2023, kanë punuar për realizimin e detyrave që rrjedhin në zbatim të Ligjit Nr. 45/2019 date 18.07.2020 'Për Mbrojtjen Civile"si dhe të VKM_së Nr.655 date 18.12.2022 “ Per ngritjen dhe funksionimin e Struktues se Sistemit Kombetar te Planifikimit dhe Perballimit te Emergjencave Civile” ,ato të planifikuara nga ana jonë, si dhe detyrat e vëna nga ana juaj, për perballimin e situatave si në	Përfunduar	Nuk ka

		<p>nr.414, dt.8.07 2021 "Për Miratimin e Procedurave dhe Kriteve të ndarjes dhe të Përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit Për Mbrojtjen Civile”, Prefekti i i Qarkut në rolin e Kryetarit të KMCQ, kërkon informacion në lidhje me masat paraprake dhe parandaluese që do ndërmerren nga anajuat për parandalimtn e situatave te pritshme emergjente sezonale (Vjeshtë-Dimër 2023-2024). Ju bëjme me dije që Brenda muajit Tetor 2023 do të organizohet takimi i radhës i KMCQ, ku do të trajtohen problemet e ndeshura dhe organizimi i operacioneve në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve dhe masat që do të merrren për parandalimin e termeteve sezonale sic jane përmbytjet. vërshimi i përrrenjve dhe izolimi nga dëbora për periudhen</p>		<p>periudhen verore ashtu edhe atë dimërore që pritet. Janë përballuar me sukses situatat e zjarreve gjatë këtyre muajve duke ulur në masë të konsiderueshme kohën e reagimit të strukturave operacionale e mbështetësë në momentin e rënies së zjarreve. Gjatë kesaj periudhe të renies së zjarreve, në Bashkinë Malësi e Madhe, pra deri në këto momente që po u informojmë janë shfaqur 120 raste, ku më të theksuara kanë qenë në territore me shkurre dhe tokë djerr, por një shqetësim i madh ka qenë edhe djegja e sipërfaqeve me bimë medicinale. kjo sidomos në Njësinë Administrative Qendër. Të gjitha rastet e rënies së zjarreve janë njoftuar e menaxhuar nga strukturat e EC,MZSH-së dhe të strukturave tjera mbështetëse të Bashkisë, duke bërë që në krahasim me vitin e kaluar sipërfaqet e përshkruara, apo të djegura të jenë më të vogla, krahasuar me vitin 2022. Vlen të theksohet se strukturat e MZSH_së, kanë punuar me</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>(Vjeshtë-Dimër 2023-2024). Me qellim mirëorganizimin e ketij takimi kërkojmë informacion nga të gjithë drejtesit e bashkive dhe të institucioneve anëtarë të K.MCQ për problemet e mëposhtëme: Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve</p> <ul style="list-style-type: none"> •Masat e marra nga inspektoriatet, agjensite dhe drejtorite. sektoret e EC të bashkive për menaxhimin e parandalimit. dhe të nderhyrjes për shuarjen e zjarreve (Sasia. rastet dhe vatrat e zjarrit) në territorin e përgjegjësise, Funksionimi i strukturave të emergjencave civile në cdo bashki. drejtori/sektor, organizimi dhe funksionimi aktual gjatë vitit 2023. •Kapacitetet njerëzore. dhe logjistike të cilat janë përdorur për shuarjen e zjarreve, (strukturat e MZSH) mbështetja nga 		<p>përkushtim e përgjegjësi duke reaguar në kohë, pavarësisht ngarkesave ditore e kohës kur janë shfaqur zjarret. Bashkëpunimi e koordinimi në kohë i informacioneve dhe vënia në efikasitet e vrojtuesve nga Ndërmarrja Pyjore. të kombinuar me strukturat e Njësive Administrative dhe Kryepleqësitë ka bërë që njoftimi për rënien e zjarreve të merret në kohë dhe për rrjedhojë dhe reagimi i strukturave operacionale të jetë i shpejtë. Rënia e zjarreve në përgjithësi ka ardhur nga pakujdesia e qytetarëve. Por ka patur edhe raste kur zjarrvënia ka qenë e qellimshme siç ishte një rast në fshatin Koplik Sipërm i cili u referua në organet ligjzbatuese. Vëmendja kryesore e strukturave tona gjatë kësaj periudhe është fokusuar në marrjen e masave për përballimin e situatës së periudhës vjeshtë-dimër ku dhe problematikat në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe nuk janë të pakta si në lidhje</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>strukturat qendrore (Zbarimi i Nenit, nr.7 të Ligjit per MC. Parimi i subsidiaritetit)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Funksionimi i sistemit të vrojtimit. shkëmbimit të informacionit në kohe reale. reagimi i strukturave në nivel vendor dhe cdo agjensi e zbatimit të ligjit. 		<p>me përmbytjet e mundshme të disa territoreve.</p> <p>Për t'iu paraprirë këtyre problematikave nga strukturat e vartësisë në Bashki janë përgatitur planet përkatëse të masave të cilat janë dërguar pranë Njësiave Administrative ku dhe aty janë organizuar e ngritur strukturat përkatëse reaguese në nivel fshati e pleqësie për të reaguar në kohë në raste përmbytje ose të bllokimit nga reshjet e dëborës.</p> <p>Nga Bordi i Kullimit në varësi të Bashkisë është punuar për pastrimin e zonave të përmbytura në zonat më problematike si Navreda-Vukpalaj dhe Gradec -Jeran ne Nj.A.Kastrat dhe në fshatin Paivarte Nj.A.</p> <p>Qënder.</p> <p>Po ashtu janë monitoruar argjinaturat e përrenjëve që përshkojnë territorin tone dhe që vitet e shkuara kanë krijuar probleme në fshatrat respektive, ku ato kalojnë, siç janë Perroi i Rrjollit, Cemit.Banushit dhe Perroi i Thatë.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

DREJTUESI I PROKURORISE
ALBERT MURÇAJ

				<p>Në Prroin e Rrjollit është ndërhyrë duke bërë riparimin e digës në fshatin Kçar i Poshtëm në një gjatësi 100m linear.</p> <p>Problemi digave të rezervuarve dhe Kanalit të Shtodrit sipas Bordit të Kullimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Janë bërë pastrime të herë pas herëshme të kanaleve. sipas problematikave të hasura gjatë vitit 2022. -Në Kanalin e Shtodrit në këtë periudhë hapen portat në mënyrë që bëhen shkarkimet e prurjeve. -Në Kanalin e Shtodrit të gjitha portat janë funksionale. -Në Bashkinë Malësi e Madhe janë funksional 2 rezervuar dhe 2 diga të rregullta. në Gruemirëçezme dhe në Zagorë. -Jo funksional janë 2 rezervuar, i Bajzës dhe i Rapshës -Në Vermosh po ndërtohet ura e re. që do të bëjë lidhjen e qendrës së Vermoshit me fshatin Velipojë. -Po punohet për pastrimin dhe disiplinimin e Lumit të Vermoshit (ndërhyrje nga DBK Lezhë) 		
--	--	--	--	--	--	--

				-Në proces: Vendosi në funksionim e Kanalit të Shtodrit. në segmentin Gruemirëçezme- Kamicë.	
9.	10.11.2023	Kërkim informacioni nëse vendi i quajtur “Vneshti, Goraj. me koordinatë N 42° 18' 34,6” ; E 19° 29' 22” në Njësinë Administrative Kastrat nën pjesë në fondin pyjorë në administrim të Drejtorisë së Pyjeve pjesë e Bashkisë Malësia e Madhe.	05.12.2023	Për sa kërkoni në shkresën tuaj Nr. 9650/1 Prot. Datë 03.11.2023 administruar nga ana jonë me shkresën Nr.2956 Prot. të datës 10.11.2023 ju sqarojmë si më poshtë Vendi i quajtur “Vneshti, Goraj. me koordinatë N 42° 18' 34,6” ; E 19° 29' 22” në Njësinë Administrative Kastrat ndodhët në tokë bujqësore dhe nuk bën pjesë në fondin pyjorë në administrim të Drejtorisë së Pyjeve pjesë e Bashkisë Malësi e Madhe.	Nuk ka